5.- Shqipëria njeh të gjithë traktatet në fuqi para 1939, të cilët nuk prekin indipendencën dhe sovranitetin e Shqipërisë të cilët nuk prekin indipendencën dhe sovranitetin e Shqipëris, dhe është gati të rishqyrtojë ndonjë ose të gjithë traktatet e lartpërmëndur, të cilët janë në interes të përbashkët të të dy anëve kontraktuese, me të gjithë Shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara, që kanë njohur Qeverinë e Republikës Popullore të Shqipëris.

./.

 

6).- (a) Raporti i të 21 incidenteve në kufirin Greko-Shqiptar i rrjeshtuar në Aneksin me Dok.S/123, ësht një seri shpifjesh fantastike dhe fabrikimesh të Qeveris Greke.

Qeveria Shqiptare bashkëngjit këtu një listë me incidente të kufirit provokuar prej Grekërve. (Shif Aneks Nr.11).

b) Më 15 Maj 1946, dy anije lufte të pa indentifikuara lundronin në drejtim të Portit të Sarandës. Passi ata kishin hyrë n'ujrat toksore Shqiptare, Rojet bregdetare Shqiptare u bënë shënja atyre për të treguar origjinën e tyre. Me qënë se shënjat nuk u përfillën, baterit e breg detit Shqiptar qëlluan disa të shtëna përpara tyre si ç'është zakon në rrethana të tilla. Të dy anijet ngritën atëhere flamurin Anglez, u kthyen përsëri dhe kaluan si ç'kishin ardhur në qetësi. Qeveria Britanike, në një notë, kërkonte shpjegime. Qeveria Shqiptare u përgjegj me një herë në një notë miqësore tue çfaqur keqardhje për këtë incident të pa dëshëruar. Arsyeja kryesore e kësaj ngjarjeje ishte se, herë pas here, anije lufte Greke ishin avitur në bregdetin Shqiptar dhe kishin qëlluar me armët e tyre pa shkak në mënyrë që të provokonin incidente, si ç'tregohet në listën e provokimeve.(Shif Aneskс Nr.11.)

c) Akuzat e bëra nën këtë drejtim janë shpifje t'imagjinuarae të poshtra. Në Shqipëri nuk ka kampe përqëndrimi. Qeveria Shqiptare nuk ka marrë asnjë ankesë për sa sipër mbi këtë subjekt nga ndonjë qeveri e jashtme.

Në lidhje me sa thashë le të shtoj informatën që vijon:

Janë pothuaj 30.000 Grekër të minoritetit që rrojnë në tetedhjet e katër katunde të Prefekturës së Gjirokastrës. Së bashku me forcat shqiptare të rezistencës, ata muerën pjesë vullnetarisht në luftën çlirimtare,luftuan trimërisht kundër Italianëve dhe Gjermanëve, dhe dhanë gjakun e bijvet të tyre më të mirë për çlirimin e Shqipëris. Ata gëzojnë të drejtat, e garantuara nga Statuti si gjithë Shtetasit Shqiptarë, si dhe lirin e përdorimit të gjuhës së tyre dhe zhvillimin e kulturës. (Shif Aneks Nr.12). Ata kanë 78 shkolla fillore dhe një Gjymnaz të gjitha të mbajtura nga Shteti Shqiptar. Atabotojnë një Gazetë në gjuhën e tyre. Ata kanë administratat e tyre lokale. Shumë prej tyre shërbejnë si oficerë në Ushtërinë Kombëtare Shqiptare. Disa të tjerë janë zyrtare të lartë në Qeverin Kombëtare. Ata janë të përfaqësuar në Parlamentin Shqiptar prej dy deputetësh. Mihal Jor-

./.

gji nga Dropulli dhe Manol Konomi nga Pogoni. Ky i fundit ësht Ministër i Drejtësis dhe Anëtar i Këshillit të kryesuar nga Kryeministri Enver Hoxha.

Përkundrazi, trajtimi i minoritetit Shqiptar i distriktit të Çamëris aneksuar nga Grekët më 1913 ësht nga më të çnjerëzishmit që ësht dëgjuar. Ata janë dbuar dhe shpërngulur sistematikisht nga shtëpit e tyre. Pasurit e tyre konfiskoheshin pa asnjë shpërblim. Përveç 60.000 vetëve të popullsis origjinale, me zor të ketë mbetur ndonjë shqiptar në atë krahinë fatkeqe. Nja 5000 prej tyre janë masakruar barbarisht prej grekërve gjat vjetit të kaluar. Nja 22.000, u shpërngulën me forcë dhe gjetën strehë në Shqipëri, ku i bëjnë një barrë të rëndë buxhetit. Afër 2000 prej tyre vdiqën rrugëve nga të ftohtit e nga uria ndërsa vinin në Shqipëri. (Shif Aneks Nr.13). Misioni i U.N.R.R.A.-s ka shpëtuar mijëra syresh. Z. Hutchison, Anëtar i Parlamentit Britanik nga Maunchester, ka treguar të vërtetën e këtyre emigrantëve në Dhomën e Komunëve. Ai rezultoi tue kërkuar nga Ministri i Jashtëm, Anthony Eden"të bëjë demarshe pranë Qeveris Greke për të hetuar për këto barbarizma" (Shif Aneks Nr.13).

Rezervohem t'i jap Komitetit informata më të plota mbi këtë subjekt në t'arthmen.

7).- Në bazë të deklaratës zyrtare Nr.3 të Këshillit Qëndror të zgjedhjeve (lëshuar më 8 Dhjetor 1945) rezultatet e zgjedhjeve në Shqipëri më 2 Dhjetor 1945 janë si vijon:

Numuri i përgjithshëm i zgjedhësve ishte 803.566; Numuri i përgjithshëm i zgjedhësve që votuan ishte 542.400, ose 89.86%; Shpërndarja e votave ishte si vijon: Për kanditatët e Frontit Demokratik 505.304 vota ose 93.16%, Kundër Frontit Demokratik 36.816 ose 7.79%; për kanditatët indipendentë 108 vota ose 0.005%.

---

STATEMENTS BY EDEN

On December 17, 1942, in answer to a question, Secretary of State for Foreign Affairs Anthony Eden declared in the House of Commons: "His Majesty's Government sympathizes with the fate of the Albanians, a people among the earliest victims of fascist aggression. They wish to see Albania free from the Italian yoke and restored to her independence."

STATEMENTS BY MOLOTOV

On December 22, 1942, the Soviet Union Foreign Commissar made a formal statement on lines similar to that of Mr. Cordell Hull. He said that "the Soviet Government is convinced that the struggle of the Albanian people will merge with the common struggle for the liberation of the rest of the Balkan countries and that they will succeed in driving the Italian invader from their soil."

Anex
No- 5

5-19

## ENGLISH TRIBUTE

The Allied Commander in the Middle East, Sir Maitland Wilson, on November 12, 1944, sent the Commander-in-Chief of the Albanian army, Colonel Enver Hoxha, the following message: "With admiration I have followed the successes which, by its own efforts, your National Liberation Army has achieved in the struggle against the common enemy and for our common aims."

An. N° - 2

12

2

CORDELL HULL'S STATEMENT

Already in 1942 the heroic struggle of the Albanian guerrilla fighters attracted the attention of the Big Three. On December 10, 1942, Secretary of State Cordell Hull made the following statement:

"The Government of the United States is not unmindful of the continued resistance of the Albanian people to the Italian forces of occupation. The effort of the various guerrilla bands operating against the common enemy in Albania is admired and appreciated. The Government and the people of the United States look forward to the day when effective military assistance can be given these brave men to drive the invader from their homes. Consistent with its well-established policy not to recognize territorial conquest by force, the Government of the United States has never recognized the annexation of Albania by the Italian crown. The joint declarations of the President and theBritish Prime Minister, made on August 14, 1941, known as the 'Atlantic Charter' provides as follows: 'Third, they respect the right of all peoples to choose the form of government under which they live, and they wish to see sovereign rights and self-government restored to those who have been forcibly deprived of them.' The restoration of a free Albania is inherent in that statement of principles."

1

## TELEGRAM

MINISTRIS JASHTME

TIRANË

Komiteti i Këshillit të Sigurimit për antarësi dëshiron informata plotësuëse mbi çështjet të poshtë shënuara Stop.

1) Qeverija Shqiptare a ka patur traktate që ekzistonin midis Shqipëris dhe shtetetve të tjera pra 7 Prill 1939?

2) Shqipërija a është pregatitur të pohoj gadishmënin e saj të pranoj vlefshmënin e traktateve dhe të marëveshtjeve që kanë qënë në fuqi n'atë datë midis Shqipëris dhe tjerëve tash anëtar të Kombeve të Bashkuara, nënkuptohet natyrisht, se si mbas praktikës së zakonshme dhe të konditave të marëveshjeve dhe vetë traktateve, qeverija Shqiptare është gjithmonë e lirë të kërkoj mbarimin e kësodore traktateve dhe marëveshjeve, mbasi të ketë pohuar njohjen e vlefshmënisë së tyre stop? Përveç kësaj Komiteti i Antarësisë kërkon informata mbi të qëlluarit që është bërë nga ana e baterive në bregdetin Shqiptar kundër dy anijeve Inglize dhe mbi dbimin nga Shqipërija t'antarëve të Komisionit Britanik të vorrezave të luftëtarëve. Stop. Lutem më njoftoni mbi zhvillimet të këtyre ngjarjeve në qoftë se ka patur ndonjë zhvillim tjetër. Stop. Lutemi më jepni me njëherë informata me hollësira të ngjarjeve në kufirin Grek, të provokacioneve duke specifikuar datën dhe vëndin e ngjarjeve. Stop. Shumë me rëndësi: A keni marë ndonjë ankim prej Qeverisë Greke ose prej ndonjë qeverije tjetër mbi keq përdorimin e Minoritetit Grek Stop.

Keni për t'u përgjegjur me shkrim gjithë këtyre pyetjeve Komitetit të Antarësisë para 12 Gusht Stop. Tuk Jakova.

Zyri
Ben dy kopje
dhe ni Dhego[?] fapi[?]
me oficerin. [signature]

1947

Pranim-Shqipërisë OKB 13/VII-1

TELEGRAM

MINISTRIS SË JASHTME

Këshilli i Sigurimit të Komitetit më lajmëroj të jem gati për dëgjimin stop.Mora prej Sekretarjatit Memorandumin e Ambasadorit(Dendramis)Grek dërguar Këshillit të Sigurimit më pesë Gusht stop.Sot vizitova kryetarin e delegacionit të Shteteve të Bashkuara Johnson në prezencën të(2/3) t'antarëve të delegacionit Amerikan stop.Pritja ka qënë e përzëmërt stop.Ay më pyeti në se Shqipërija,e cila në kundërshtim të së drejtës ndërkombëtare abrogoj traktatet me Shtetet e Bashkuara,është e dispozuar(capable)të respektojë obligimet ndërkombëtare stop.Ay shtoj se qeverija Amerikane është hala duke pritur një përgjegje të favorshme nga qeverija Shqiptare në lidhje me traktatet stop.Shtoi se qeverija Shqiptare mund ose të pranonte vlefshmëninë e gjith traktateve ose të denonconte ata që mund t'i dukeshin të vrejtshëm në qoftë se kish të tillë stop.Ay foli gjithashtu për tratamentin e keq t'antarëve të Misionit Amerikan stop.Sidoqoftë më siguroj se me gjith këtë qeverija Amerikane nuk ka vendosur të kundërshtojë pranimin e Shqipërisë në U.N.O.stop.Ju përgjegja se pres të bëj një vizitë miqësore ke Ministri i Punëve të Jashtme brënda pakë ditëve dhe të marë njoftim të pikpamjes Amerikane rreth traktateve stop. Tuk Jakova.

Nr. 62

21-7-47

3

MINISTRISË JASHTME

TIRANË

Komiteti për admisionin shqyrtoi sot kërkesën t'onë për anëtarësi. Nesër mundet të jepet vendimi. Delegati Amerikan dhe delegati Engles kundra. Delegati Francez i lëkundshëm por më afër. Delegati Amerikan dhe Englez përdorën si argument kondra Qeverisë Shqiptare se nuk jep prova bashkëpunimi me Organizatën e Kombeve të Bashkuara, si shëmbull u përmënt Komisioni Hetimor dhe vendimi i Këshillit Sigurimit drejtuar Gjyqit të Hagës dhe mos bashkëpunimi t'onë me nën Komisioni Hetimor. Këtë të fundit e forcuan dhe duan t'a forcojnë me mos përgjigjien t'uaj. Na njoftoni më gjërë si dhe kur ju drejtuat Komisionit Hetimor të Këshillit Sigurimit për çështjen greke, pse ;;.. njoftoni Sekretariatin e UNO-s ... (n d t ë b) aprovoni heti.... që kur të bisedohet gjend (m e t e k) Qeverija Shqiptare (h i t e t i) për admisionin nga Keshilli i Sigurimit.

NESTI

L.I. 464/III Res
22-7-47

A

159

Paris le, 2 Décembre 1948.-

Monsieur le Secrétaire Général,

Au nom du Gouvernement de la République Popůlaire d'Albanie, étant dument autorisé en vertu de pleins pouvoirs donnés à cet effet par le Président du Conseil des Ministres et Ministre des Affaires Etrangères Général Colonel Enver HOXHA, je déclare que la République Populaire d'Albanie accepte par la présente sans aucune réserve quelconque les obligation de la Charte des Nations Unies et s'engage à ne commettre aucune violation à partir du jour où elle sera Membre des Nations Unies.

Veuillez agréer, Excellence, les assurances de ma très haute considération.

( Theodor Heba )

Theodor Heba

Ministre Plénipotentiaire et
Représentant de l'Albanie à l'O.N.U.

A Son Excellence
Monsieur Trygve Lie,
Secrétaire Général de l'Organisation
des Nations Unies;

Palais de Chaillot
PARIS.

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË
Kryeministrija

A

Tiranë, le 10. Juillet 1952

N. prot.

SECRETARIAT DE L'ORGANISATION DES NATIONS UNIES,

NEW YORK
U.S.A.

Le Gouvernement de la République Populaire d'Albanie en tant que Gouvernement d'un pays allié qui pendant la deuxième guerre mondiale a contribué à la victoire commune sur le fascisme, inspiré par le désir du renforcement de la coopération internationale et par celui du rétablissement d'une paix durable, depuis le mois de janvier 1946 a demandé à être admis comme membre de l'Organisation des Nations Unies en soulignant qu'il accepte la Charte ainsi que les obligations qui découlent pour lui de ce fait.

Le Gouvernement de la République Populaire d'Albanie renouvelle encore une fois cette demande légitime du peuple albanais et en même temps il appuie entièrement la proposition du Représentant permanent de l'Union Soviétique auprès l'Organisation des Nations Unies I.A. Malik que le Conseil de Sécurité recommande à l'Assemblée Générale l'admission simultanée comme membres de l'Organisation des Nations Unies des 14 Etats qui ont demandé à être admis et qui invite le Conseil de Sécurité à prendre une décision dans ce sens.

PRESIDENT DU CONSEIL DES MINISTRES ET
MINISTRE DES AFFAIRES ETRANGERES
DE LA R.P. D'ALBANIE

Enver Hoxha

(GENERAL D'ARMEE ENVER HOXHA)

KRYETARIT TE KESHILLIT SIGURIMIT

N E W - Y O R K   U. S. A.

Qeveria e Republikes Popullore te Shqiperise, si Qeveri e nje vendi aleat qe gjate luftes se dyte botnore dha kontributin e vet per fitoren e perbashket mbi fashizmin, e frymezuar nga deshira e perforcimit te bashkepunimit nderkombetar dhe nga ajo e vendosjes te nje paqeje te qendrueshme, qysh me Janar 1946 ka kerkuar qe te pranohet si antare e Organizates se Kombeve te Bashkuara duke vene ne dukje se ajo pranon Karten e saj si dhe detyrimet qe rrjedhin prej saj.

Qeveria e Republikes Popullore te Shqiperise perserit edhe nje here akoma kete kerkese legjitime te popullit shqiptar dhe njekohesisht mbeshtet plotesisht propozimin e Perfaqesuesit te perhereshem te Bashkimit Sovjetik prane Organizates se Kombeve te Bashkuara Zotit I.A. Malik qe Keshilli i Sigurimit ti rekomandoje Assamblese se Pergjitheshme qe te pranohen njekohesisht si antare te Organizates se Kombeve te Bashkuara te 14 Shtetet qe kane kerkuar te pranohen dhe qe fton Keshillin e Sigurimit te marri nje vendim te tille.

KRYETAR I QEVERISE SE R.P. TE SHQIPERISE
DHE MIN. P. TE JASHTEME:
( Gjen. Armate ENVER HOXHA )

Datë 9 tetor 1954

N° 1303.-

N° 02-2380.- Sekret
dt. 11/X/1954.-

**T E L E G R A M** ELT

SON EXCELLENCE MONSIEUR VAN KLEFFENS
PRESIDENT DE L'ASSEMBLEE GENERALE DES NATIONS UNIES
NEW-YORK

Ai honneur porter à votre connaissance ce qui suit: Gouvernement albanais poursuivant sa politique de paix et de collaboration internationale renouvelle sa demande pour admission de République Populaire Albanie comme membre des Nations Unies.

Gouvernement de République Populaire Albanie fidèle à volonté du peuple albanais d'édifier en paix sa vie nouvelle et heureuse et vivre en bonne entente avec tous les peuples a toujours appuyé et appliqué résolument la politique des relations de bon voisinage et de compréhension avec tous les etats. Peuple albanais et son gouvernement sont et luttent de façon conséquente pour consolidation de paix et détente dans relations internationales. Grace à politique sage et pacifique du Gouvernement albanais République Populaire Albanie est devenue un facteur important de paix de stabilisation et de compréhension dans Balkans et en Europe. République Populaire Albanie a établi des relations diplomatiques normales et de collaboration avec nombre d'etats elle a des relations diplomatiques normales avec etats voisins Yougoslavie Italie et à cette dernière elle a proposé établissement des relations commerciales entre deux pays. Gouvernement albanais a fait des efforts en vue d'établir des relations normales avec son voisin Grèce. Il ne manquera pas dans avenir aussi de faire tout son possible en vue de contribuer à établissement de relations justes et de bon voisinage avec tout etat le désirant sincèrement.

Conformément à sa politique de collaboration internationale République Populaire Albanie participe aujour'hui dans plusieurs conventions et organisations internationales y compris institutions spécialisées des Nations Unies. Elle prend une part active dans ces organisations et lutte pour application de principes justes dans solutions des problèmes internationaux.

C'est dans esprit de cette politique que depuis 1946 Gouvernement albanais a plus d'une fois présenté sa demande pour admission de République Populaire Albanie comme membre des Nations Unies en vue d'y associer ses efforts pour développement des relations de compréhension et de collaboration entre Nations et règlement des problèmes internationaux par des moyens pacifiques. Mais jusqu'à présent ni sacrifices immenses qu'à fait peuple albanais pendant guerre aux cotés des Puissances alliées ni politique juste du Gouvernement albanais n'ont été appréciées comme il se doit pour reconnaitre à République Populaire Albanie son droit légitime de prendre place qui lui revient dans Organisation des Nations Unies.

République Populaire Albanie a donné toutes preuves qu'elle remplit entièrement conditions de Charte en tant qu'etat souverain poursuivant une politique pacifique de compréhension mutuelle

et de collaboration internationale. En présentant une nouvelle fois sa demande Gouvernement de République Populaire Albanie réitère sa déclaration qu'il accepte sans aucune réserve toutes les obligations de Charte des Nations Unies et est disposé à les remplir.

Gouvernement de République Populaire Albanie espère que dans sa session actuelle Assemblée Générale prendra en considération les droits légitimes de République Populaire Albanie et qu'elle décidera en faveur de son admission à Organisation des Nations Unies. Une telle décision est conforme aux pricipes élevés de Charte et à volonté des peuples que Nations Unies soient un centre international où s'unissent et collaborent tous etats libres et souverains indépendamment de leurs systèmes politiques et sociaux.

Veuillez agréer Monsieur le Président les assurances de ma plus haute considération.

BEHAR SHTYLLA
MINISTRE DES AFFAIRES ETRANGERES
REPUBLIQUE POPULAIRE D'ALBANIE

-Kerkohet pranimi i R.P.Sh. në O.K.B.-

B/VI-1
Kob: Pranimi OKB
B. VI-1
8

teksti definitif i aprovuar.—
9/X/54

SHKELQESIS TIJ ZOTIT VAN KLEFENS
PRESIDENT I ASAMBLES SE PERGJITHSHME TE
KOMBEVE TE BASHKUARA

NEW - YORK

Kam nderin te sjell ne dijenin t'uaj sa vijon:

Qeveria shqiptare, duke ndjekur politiken e saj te paqes dhe te bashkepunimit nderkombtar, perserit kerkesen per pranimin e Republikes Popullore te Shqiperise si antare te Kombeve te Bashkuara.

Qeveria e Republikes Popullore te Shqiperise, besnike e vullnetit te popullit shqiptar per te ndertuar ne paqe jeten e tij te re dhe te lumtur dhe per te rojtur ne mareveshje me te gjithe popujt, ka perkrahur gjithenje dhe ka zbatuar vendosmerisht politiken e marredhenieve te fqinjesise se mire dhe te mirekuptimit me te gjithe shtetet. Populli shqiptar dhe Qeveria e tij jane dhe luftojne ne menyre konsekuente per forcimin e paqes dhe uljen e tensionit ne maredheniet nderkombetare. Politika e urte paqedashese e Qeveris shqiptare ka bere qe Republika Popullore e Shqiperise te jete nje faktor i rendesishem paqeje, stabiliteti dhe mirekuptimi ne Ballkan e ne Europe. Republika Popullore e Shqiperise ka vendosur maredhenie dipllomatike normale dhe bashkepunimi me nje sere shtetesh, ajo ka maredhenje dipllomatike normale me shtetet fqinj, Jugosllavi, Itali, dhe kesaj te fundit i ka bere propozimin per vendosjen e maredhenieve tregetare midis dy vendeve. Qeveria shqiptare ka bere perpjekje per normalizimin e marredhenjeve me fqinjen e saj Greqine. Ajo nuk do te mungoje edhe ne te arthmen te kontribuoje me te gjitha mundesit per vendosjen e maredhenjeve te drejta dhe te fqinjesis se mire me cilindo shtet qe desheron sinqerisht kete.

./.

Ne zbatim te politikes se bashkepunimit nderkombetar Republika Popullore e Shqiperise ben pjese sot ne shume konventa dhe organizata nderkombetare, duke perfshire edhe Organizatat e specializuara te Kombeve te Bashkuara. Ajo merr pjese aktive ne keto organizata dhe lufton per zbatimin e parimeve te drejta ne zgjidhjen e problemeve nderkombetare.

Ne frymen e kesaj politike Qeveria shqiptare qe prej vitit 1946 ka paraqitur disa here kerkesen per pranimin e Republikes Popullore te Shqiperise si antare te Kombeve te Bashkuara me qellim qe te jape kontributin e saj ne zhvillimin e maredhenieve te mirekuptimit dhe te bashkepunimit midis kombeve dhe ne zgjidhjen e problemeve nderkombetare me mjete paqesore. Por deri sot as sakrificat e medha qe ka bere populli shqiptar gjate luftes perkrah Fuqive aleate as politika e drejte e Qeveris shqiptare nuk jane çmuar si duhet per ti njohur Republikes Popullore te Shqiperise te drejten legjitime qe te zeje vendin qe i takon ne Organizaten e Kombeve te Bashkuara.

Republika Popullore e Shqiperise ka dhene çdo prove se ploteson te gjitha kondita e Kartes si Shtet sovran qe ndjek nje politike paqesore, mirekuptimi reciprok dhe bashkepunimi nderkombetar. Duke paraqitur edhe nje here kerkesen e saj Qeveria e Republikes Popullore te Shqiperise perserit deklaraten se ajo pranon pa asnje rezerve te gjitha detyrimet qe rjedhin nga Karta e Kombeve te Bashkuara dhe eshte e gateshme ti plotesoje ato.

Qeveria e Republikes Popullore te Shqiperise shpreson se ne sesionin e saj te nende Asamblea e Pergjitheshme do te mare parasysh te drejtat legjitime te Republikes Popullore te Shqiperise dhe do te vendose ne favor te pranimit te saj ne O.K.B. Nje vendim i tille esht ne pajtim me parimet e larta te Kartes dhe me vullnetin e popujve qe Kombet e Bashkuara te jene nje qender nderkombetare ku te bashkohen dhe te bashkepunojne te gjithe shtetet e

./.

lire dhe sovran, pamvaresisht nga sistemet e tyre politike dhe shoqerore.

Ju lutem pranoni, Zoti President, sigurimet e konsiderates s'ime me te larte.

KRYETARI KESHILLIT TE MINISTRAVE
TE REPUBLIKES POPULLORE TE SHQIPERISE

( MEHMET SHEHU )

Behar Shtylla
Minister i Puneve te Jashtme

CESHTJA E PRANIMIT TE REPUBLIKES POPULLORE TE SHQIPËRISË NE ORGANIZATEN E KOMBEVE TE BASHKUARA

Qysh para thirrjes se konferences se San-Franciskos (25 prill - 26 qershor 1945), duke pare se qeveria e SHBA, qe kishte marre përsipër thirrjen e konferences, nuk i dergoi vendit tone ftese për te marrë pjese ne kete konferencë, Qeveria Demokratike e Shqiperisë ne telegramin e saj date 29 mars 1945 drejtuar tre fuqive të mëdha (BRSS, SHBA dhe Britanisë së Madhe) kerkonte nderhryejn e tyre ne menyre qe edhe Shqiperia të ftohej ne konferencen e San-Franciskos. Por departamenti i shtetit i SHBA refuzoi te mbeshteste kerkesen tone nen pretekstin se proçedura e caktuar nuk parashikon pjesemarrjen e qeverive akoma te pa njohura. Kryetari i konferences Eduard Shtetinius iu përgjigj negativisht edhe kerkeses se përsëritur te Qeverise Demokratike te Shqiperisë, derguar me 27 prill 1945, nen pretekstin se qeveria e SHBA nuk mund te mbeshtese kerkesen e nje qeverie, te cilen ajo akoma nuk e ka njohur.

Ne prag te çeljes se sesionit te pare te Asamblese se Përgjitheshme te OKB (10 janar 1946), më 20 dhjetor 1945 Qeveria Demokratike e Shqipërisë i beri nje kerkese kryetarit te komisionit pregatitor lidhur me pranimin e Shqiperisë ne OKB. Më 16 janar 1946 ajo ua përserit kerkesen e saj kryetarit dhe zevendes-kryetareve te Asamblese se Përgjitheshme. Më 25 janar 1946 kerkesa u paraqit për diskutim ne Keshillin e Sigurimit, i cili me 28 janar 1946 me shumicë votash vendosi te përfshije kerkesen ne rendin e dites. Por ne kete kohë ministri grek i puneve te jashtme i drejtoi nje leterë Këshillit te Sigurimit, duke akuzuar Shqipërine se ajo gjoja ka marre pjese ne luften e dyte boterore kunder Greqisë, prandaj, me propozim te delegacionit te SHBA, diskutimi i kerkeses se Shqiperise me shumicë votash u shty për nje kohë të pacaktuar. Më 17 maj 1946 Keshilli i Sigurimit filloi nga diskutimi i kesaj kerkese, por përseri e shtyu gjer ne gusht 1946. Më 5 gusht përfaqesuesi grek paraqiti nje memorandum, në të cilin, përveç akuzes se mepareshme, përmbahej akuza çpifëse se Shqiperia gjoja kry-

en provokime kufitare kunder Greqise dhe se për kete aresye ajo ndodhet në gjendje lufte me Greqine. Më 28 dhe 29 gusht për shkak te vetos se SHBA dhe Britanisëx së Madhe Keshilli i Sigurimit e shtyu përseri çeshtjen e pranimit te Shqiperisë ne OKB, duke iu referuar mungeses se marredhenieve diplomatike midis tyre dhe Shqiperisë dhe duke përseritur dyshimet e trilluara lidhur me qellimet paqedashese te rendit te ri te Shqiperisë.

Qeveria e Republikes Popullore te Shqiperisë e përseriti kerkesen e saj më 17 tetor 1946 pas çeljes se gjysmes se dyte te sesionit te pare te Asamblese se Përgjitheshme te OKB, por Sekretari i Përgjithshëm xx u përgjegj se ai nuk mund ta përfshije ate ne rendin e dites te punimeve te Asamblese pa rekomandimin përkatës te Keshillit te Sigurimit.

Në vitet e mëpastajme para sesionit te VIII te Asamblese se Përgjitheshme te OKB ne vitin 1953, çeshtja e pranimit te Shqiperisë u lidh me pranimin e anëtareve te tjere, te cilet kishin bere kerkese për t'u pranuar anetare te OKB. Gjate kesaj periudhe kjo çeshtje u diskutua si ne Asamblene e Përgjitheshme, xx ashtu edhe xxxxxx ne organet e saj - ne Komitetin Nr.I dhe ne Keshillin e Sigurimit. Por asnje vendim nuk u muarr për shkak te qendrimit negativ te SHBA dhe satelitëve te tyre, te cilet, ne saje te mekanizmit te votës e hodhen poshtë propozimin e delegacionit sovjetik për te pranuar si anetare te OKB te gjitha vendet qe kishin bere kerkese, dhe ngulen kembe për te pranua si anëtarë vetëm ato shtete, te cilat i binden verbërisht diktatit amerikan.

Gjate punimeve te sesionit VIII te Asamblese se Përgjitheshme te OKB Komitetit Politik Special iu paraqiten dy projekt-rezolutash: një nga Bashkimi Sovjetik, i cili parashikonte pranimin si anëtarë te OKB te Bullgarisë, Rumanisë, Shqiperise, Finlandes dhe Italisë, lidhur me te cilët fuqite e mëdha kishin marre zotime ne përputhje me traktatin e paqes te ndihmonin ne pranimin e tyre ne OKB, dhe një tjeter nga Peruja,

i cili u aprovua mmxxmmm nga shumica e satelitëve amerikanë. Ne bazë te projektit te Perusë u krijua nje komitet ndërmëjetësimi për diskutimin e kesaj çeshtjeje me anetaret e Keshillit te Sigurimit,duke u mbeshtetur ne nenin 4 te Kartës. Me mbarimin e punimeve,ky komitet duhet t'i paraqiste nje raport Asamblese se Përgjitheshme ~~xx~~ në sesionin VIII ose jo me vone ~~se ne~~ sesionin IX te OKB. Por me qe ky raport nuk u paraqit ne sesjonin e VIII,ai do te paraqitet ne sesionin e ardhshëm.

6

MINISTRIT TE PUNEVE TE JASHTEME

T I R A N E

Kam nderin t'ju njoftoj se Asambleja e Pergjitheshme e Kombeve te Bashkuara ne mbledhjen e saj plenare te peseqintepesedhjetepese te mbajtur me 14 dhjetor 1955, duke vepruar ne baze te rekomandimit te Keshillit te Sigurimit, mori ne shqyrtim kerkesen e Shqiperise dhe vendosi te pranojë vendin tuaj antar te Kombeve te Bashkuara, se bashku me Jordanine, Irlanden, Portugalin, Hungarine, Italine, Austrine, Rumanine, Bullgarine, Finlanden, Ceilonin, Nepalin, Libine, Kamboxhen, Laosin dhe Spanjen.

Une marr pjese ne kenaqesine e thelle t'antareve te Kombeve te Bashkuara per kete vendim.

Une do te prisnja me mirenjohje kredencialet e perfaqesuesit zyrtar te Qeveris suaj ne Kombet e Bashkuara.

Pranoni, Zotni, sigurimet e konsiderates sime me te larte.

15 dhjetor 1955.

DAG HAMMARSKJOLD

SEKRETAR I PERGJITHESHM
I KOMBEVE TE BASHKUARA

NJU-JORK

5

TELEGRAM

BLT

MONSIEUR DAG HAMMARSKJOLD
SECRETAIRE GENERAL DES NATIONS UNIES
NEW-YORK

J'ai l'honneur d'accuser réception de votre télégramme Nº 113 en date d'aujourd'hui par lequel vous avez bien voulu m'informer de la décision de l'Assemblée Générale sur l'admission de la République Populaire d'Albanie à l'Organisation des Nations Unies.

Le Gouvernement de la République Populaire d'Albanie a pris connaissance avec satisfaction de cette juste décision de l'Assemblée Générale et, en son nom, je vous prie d'agréer nos remerciements pour les sentiments de sympathie que vous exprimez à cette occasion en votre nom ainsi qu'au nom des pays membres des Nations Unies.

Je ne manquerai pas de vous faire connaitre bientot le nom du Représentant officiel du Gouvernement de la République Populaire d'Albanie aux Nations Unies.

Veuillez agréer, Monsieur le Secrétaire Général, les assurances de ma plus haute considération.

BEHAR SHTYLLA
MINISTRE DES AFFAIRES ETRANGERES
DE LA REPUBLIQUE POPULAIRE D'ALBANIE

7

Nr. 500

# T E L E G R A M

~~ELT~~

ZOTIT DAG HAMMARSKJOLD
SEKRETAR I PERGJITHESHM I KOMBEVE
TE BASHKUARA

N J U - J O R K

Kam nderin te njoftoj marrjen e telit tuaj Nr.113 me daten e sotme me anen e te cilit patet miresine te me njoftoni vendimin e Asamblese se Pergjitheshme mbi pranimin e Republikes Popullore te Shqiperise ne Organizaten e Kombeve te Bashkuara.

Qeveria e Republikes Popullore te Shqiperise mori dijeni me kenaqesi per kete vendim te drejte t'Asamblese se Pergjitheshme dhe, ne emer te saj, ju lutem te pranoni falenderimet tona per ndjenjat e simpathise qe shprehni me kete rast ne emerin tuaj sidhe ne emerin e shteteve antare te Kombeve te Bashkuara.

Nuk do te mungoj qe se shpejti t'ju bej te ditur emerin e Perfaqesuesit zyrtar te Qeverise se Republikes Popullore te Shqiperise ne Kombet e Bashkuara.

Pranoni ju lutem, Zoti Sekretar i Pergjitheshm, sigurimet e konsiderates sime me te larte.

BEHAR SHTYLLA
MINISTER I PUNEVE TE JASHTEME TE
REPUBLIKES POPULLORE TE SHQIPERISE

15 Dhjetor 1955